

# DEKLARATË

## Me edukim seksual në shkolla për rini më të shëndetshme dhe më të sigurt

*“Edukimi gjithëpërfshirës seksual do t’u mundësojë të rinjve të fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera që do t’i inkurajojnë ata të vlerësojnë shëndetin, mirëqenien dhe dinjitetin e tyre; për të zhvilluar marrëdhënie shoqërore dhe seksuale të bazuara në respektin e ndërsjellë; për të kuptuar se si zgjedhjet e tyre ndikojnë në mirëqenien e tyre dhe mirëqenien e të tjerëve, dhe të njohin dhe mbrojnë të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues.”*

UNESCO, 2018

Duke pasur parasysh se numri i lindjeve nga të miturat në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pothuajse tre herë më i lartë se në vendet e Bashkimit Evropian<sup>1</sup>;

Nëse dihet se të rinjtë në vendin tonë informojnë se relativisht marrëdhënien e parë seksuale e kanë më herët, ndryshe nga bashkëmoshatarët e vendeve të Evropës Perëndimore<sup>2</sup>;

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë së Veriut është në një nga vendet e fundit në Evropë për përdorimin e kontracepsionit modern me vetëm 14% të të rinjve të moshës 20 deri në 24 vjeç që përdorin një kontraceptiv modern, ndërsa shumica (36%) mbështeten në ndërprerjen e marrëdhënieve seksuale si një metodë mbrojtjeje nga shtatzënia e paplanifikuar<sup>3</sup>;

Nëse e dimë se 52% e vajzave tona të moshës 15 vjeç dhe 29% e djemve të së njëjtës moshë vuajnë nga simptoma të shumta psikosomatike në të njëjtën kohë, disa herë në javë<sup>4</sup>;

Nëse dihet se 50% e të rinjve në moshën 15 vjeçare të paraleleve në gjuhën shqipe dhe 25% e të rinjve të paraleleve në gjuhën maqedonase pranojnë role tradicionale gjinore, si p.sh., që burri duhet të jetë autoriteti në familje dhe gruaja duhet të synojë të jetë një nënë dhe bashkëshorte e mirë në kurriz të avancimit në karrierë<sup>5</sup>;

<sup>1</sup> Clark, S. et al. (2019). UNFPA Country Programme Evaluation Report Period covered by the evaluation: (2012-2018)- The Republic of North Macedonia, UNFPA

<sup>2</sup> Veliq-Stefanovska, V. et al. (2017). Raport i një studimi të sjelljes për HIV/AIDS/IST dhe SRH tek të rinjtë në Republikën e Maqedonisë në vitin 2017, Instituti i Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë, [ph.mk/wp-content/uploads/2019/03/Mladi-2018.pdf](http://ph.mk/wp-content/uploads/2019/03/Mladi-2018.pdf)

<sup>3</sup> Multiple Indicator Cluster Survey 2018-2019, State Statistical Office, UNFPA & UNICEF

<sup>4</sup> Qostarova-Unkovska, L., A kemi fitues? Pabarazitë gjinore në perspektivat shëndetësore dhe jetësore të adoleshentëve nga Maqedonia e Veriut. Gjetjet e studimit - Sjelljet e lidhura me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollore (11, 13 dhe 15 vjeç) HBSCM [http://coalition.org.mk/wpcontent/uploads/2019/11/margini\\_neednakvosti\\_final.pdf](http://coalition.org.mk/wpcontent/uploads/2019/11/margini_neednakvosti_final.pdf)

# DEKLARATË

Nëse dihet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut të rinjtë nga mosha 15 deri në 18 vjeç janë më të ekspozuar ndaj dhunës, për dallim nga grupmoshat e tjera në vend<sup>6</sup>, dhe se të rinjtë që i përkasin grupit LGBTI deri në katër herë më shpesh ngacmohen në shkollë se sa bashkëmoshatarët e tyre heteroseksualë<sup>7</sup>;

Duke u nisur nga fakti se në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pra Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Konventa për të drejtat e fëmijës u rekomandojnë shteteve futjen e edukimit seksual në arsimin fillor dhe të mesëm për t'i garantuar të drejtat themelore individuale për jetë, shëndet, mosdiskriminim, arsim dhe informacion;

Duke marrë parasysh rekomandimet specifike për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Komiteti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (2016)<sup>8</sup> dhe Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit (2018)<sup>9</sup> të Kombeve të Bashkuara për të siguruar që “adoleshentët të kenë qasje për informacione të sakta për shëndetin dhe të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese në shkolla... dhe në “mësimdhënien në shkollë për të integruar edukimin e detyrueshëm seksual, i cili është i përshtatshëm për moshën shkollore... dhe për të siguruar që mësuesit të kenë një rol të rëndësishëm në trajtimin e me stereotipet gjinore”;

Duke marrë parasysh përkushtimet kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për futjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual të dhënë në Samitin në Nairboi (2019) dhe Forumit për barazi të gjeneratës në Paris (2021), për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e të rinjve thelbësisht dhe në afat të gjatë;

Duke marrë parasysh se në politikat dhe ligjet nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht Strategjia kombëtare për të rinjtë 2016 – 2025, Strategjia kombëtare për barazi gjinore 2021 – 2026, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, Koncepti për arsimin fillore, njihet nevoja për t'u përmirësuar përmbajtja e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe për të futur edukimin seksual gjithëpërfshirës në sistemin arsimor;

Në fund, duke përshëndetur vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të marrë në seancën e 162-të për futjen e pilot programit për edukim gjithëpërfshirës seksual në klasën e 9-të të arsimit fillor, në përputhje me informacionin e prezantuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

<sup>7</sup> Gostarova-Unkovska, L., A kemi fitues? Pabarazitë gjinore në perspektivat shëndetësore dhe jetësore të adoleshentëve nga Maqedonia e Veriut. Gjetjet e studimit - Sjelljet e lidhura me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollore (11, 13 dhe 15 vjeç) HBSCM [http://coalition.org.mk/wpcontent/uploads/2019/11/margini\\_neednakvosti\\_final.pdf](http://coalition.org.mk/wpcontent/uploads/2019/11/margini_neednakvosti_final.pdf)

<sup>6</sup> OSCE – Organisation for Security and Co-operation in Europe. 2019. A study by OSCE into the violence against women in North Macedonia.

<sup>8,9</sup> Committee on Economic, Social and Cultural Rights. 2016. Concluding observations on the combined second to fourth periodic reports of the Former Yugoslav Republic of Macedonia.



# DEKLARATË

Por duke e theksuar edhe shqetësimin nga vendosja në rritje e përmbajtjeve false dhe manipuluese në hapësirën publike kundër edukimit seksual, e cila e dëmton mundësinë e përmirësimit të mirëqenies së fëmijëve nëpërmjet futjes së EGJS, si dhe përforcohen stereotipat gjinore dhe nxitet më shumë urrejtja dhe diskriminimi ndaj grave dhe grupeve të tjera të cenueshme të qytetarëve në vend, jo karakteristike për shoqëritë demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Ne, shoqatat dhe organizatat profesionale të nënshkruara, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e arsimit dhe shkencës, në përputhje me angazhimet dhe kompetencat e dhëna politike, për të siguruar që çdo fëmijë në vend do të jetë në gjendje të gëzojë të drejtën e tij për edukim gjithëpërfshirës seksual dhe të fitojë njohuri, qëndrime dhe aftësi reale për të mbrojtur shëndetin, mirëqenien dhe mirëqenien e tyre dhe dinjiteti, pra:


- Futja e edukimit gjithëpërfshirës seksual si lëndë fakultative për nxënësit e klasës së 9-të në arsimin fillor, e bazuar në fakte shkencore dhe mjekësore dhe e përshtatshme për moshën e fëmijëve dhe që është në përputhje me parimet e konceptit të arsimit fillor për arsimin me ndjeshmëri gjinore dhe gjithëpërfshirës;
- Organizimi dhe zbatimi i fushatave informuese për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet shëndetësore, emocionale dhe sociale për fëmijët nga mësimi i edukimit gjithëpërfshirës seksual;
- Investim i vazhdueshëm në njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve të shkollave fillore për realizimin efikas të lëndës zgjedhore nga edukimi gjithëpërfshirës seksual;
- Krijimi i programeve dhe mekanizmave të posaçëm dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi ndaj fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme.

# NËNSHKRUES

Shoqata e punëtorëve social të Maqedonisë – SHPSM, Shkup



Shoqata e mjekëve shqiptarë



Shoqata e mjekëve të mjekësisë së përgjithshme – mjekësia familjare



Instituti për martesë, familje dhe praktikë sistematike – Alternativa



Koalicioni “Margjinat”



Shoqata maqedonase e gjinekologëve dhe obstetrikave



Shoqata maqedonase e juristëve të rinj




Shoqata e mjekëve maqedonas – SHMM dhe shoqatat profesionale-specialistë pranë SHMM



Qendra psikologjike – Alternativa



Lidhja e edukatorëve special dhe rehabilituesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut



Fronti subversiv



HERA – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim



Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut



Qendra për veprim psiko-social dhe të krizës - Malinska



Qendra për mjekësi familjare pranë Fakultetit të Mjekësisë

